



**REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT**



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

UDHËZUESI PËR APLIKANTËT

THIRRJE PUBLIKE

**FONDI PËR SUBVENCIONIMIN E START-UP ,MIKRONDËRMARRJEVE, DHE
BIZNESET E GRAVE**

2025

Autoriteti kontraktues:

**KOMUNA E FERIZAJT
Afati për dorëzimin e aplikacioneve:
Nga data 16.05.2025-26.05.2025**

Qëllimi :

Komuna e Ferizajt lanson Fondin për subvencionimin e start-up, bizneseve, ku për synim ka promovimin dhe mbështetjen për zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve prodhuese dhe shërbyese, rritjen e konkureshmerisë së produkteve dhe shërbimeve, krijimin e vendeve të reja të punës, krijimi i mundësive bizneseve për qasje në financa, zëvendësimi i importeve dhe nxitja e eksportit si dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik lokal. Për të arritur rezultate të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik lokal, është e domosdoshme që të mundësohen forma të reja të prodhimit dhe të teknologjive të reja për të rritur produktivitetin, stabilitetin, dhe qëndrueshmërinë e bizneseve në sistemin e prodhimit, përpunimit dhe shërbimit.

Komuna e Ferizajt ka për objektiv të mbështes këto kategori: prodhimin, përpunimin dhe shërbimet.

Gjithashtu ky fond inkurajon aplikime me projekte inovative nga gratë dhe të rinjtë, të rejtat, sikur që ju bënë thirrje komuniteteve jo shumice dhe personave me aftësi të kufizuara të aplikojnë në kuadër të kësaj thirrje.

Komuna e Ferizajt përmes këtij fondi mbetet e perkushtuar e mbështetëse projektet e qëndrueshme të udhëhequra nga gratë, të fuqizoj gratë dhe të rinjtë në të bërit biznes si dhe të rrisë kapacitetet e tyre profesionale, menaxheriale për një qëndrueshmeri afatgjatë të biznesit.

1.1. Synimi Kryesor

Kjo thirrje publike ka për synim kryesor zhvillimin e ekonomisë lokale përmes mbështetjes për bizneset ekzistuese dhe krijimin e bizneseve të reja duke ofruar mbështetje në ngritjen e kapaciteteve për bizneset ekzistuese dhe avancime të reja teknologjike në pajisje dhe makineri të nevojshme në procesin e punës. Po ashtu përmes mbështetjes publike dhe krijimit të bizneseve start up synohet zvogëlimi i papunësisë.

1.2. Synimet specifike

- Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për gratë, të rinjtë, të rejtat dhe komuniteteve jo shumice dhe personave me aftësi të kufizuara
- Përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial në rritje;
- Stimulimi i zhvillimit ekonomik lokal përmes prodhimit dhe përpunimit;

1.3. Përkrahja financiare publike e ofruar nga autoriteti kontraktues

Buxheti i përgjithshëm i kësaj thirrje është 100,000.00(njëqind mijë euro) Buxhet i cili subvencionohet në investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, si dhe duke përfshirë asetet që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm, paisjet duhet të jenë të reja.

Komuna e Ferizajt, shumën e fondit të vendosur në dispozicion për vitin 2025, do ta ndajë në tre kategori:

1.4. LOT I- Bizneset Start Up,

Ky fond ka për qëllim krijimin e bizneseve të reja dhe ofrimin e mundësive për të rinjë/të reja për zhvillimin e ideve të tyre inovative. **Shuma maksimale e financuar nga ana e Komunës së Ferizajt për një përfitues tek Loto I është 2,000.00 € (dy mijëeuro).**

1.5. Kriteret e nevojshme për aplikim per LOT I-Bizneset Start-up

1. Regjistrimi i biznesit duhet të bëhet pas përfitimit të grantit dhe para nënshkrimit të kontratës.
2. Të jetë biznes që operon në Komunën e Ferizajt ku edhe do të bëhet investimi;
3. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës përpos pronarit me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
4. Pronari/ja i/e biznesit duhet të jete banor i Komunës së Ferizajt (të dëshmohet me Çertifikat të Vendbanimit)

Vërejtje: nuk subvencionohen veglat e punës,subvencionohen vetëm paisjet e punës

1.6.Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim LOT 1- Start-up përfshijnë:

1. Formulari i Aplikimit për LOT 1- Bizneset Start UP;
2. Kopja e dokumenti identifikues personal valid i lëshuar nga Republika e Kosovës;
- 3.Oferta (Profatura) për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt (*oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit në ofertë dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës, gjithashtu oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje për mbështetje*). ¹ **Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO**
- 4.Çertifikata e Vendbanimit (e lëshuar pas datës së thirrjes publike).

Vërejtje :Vlerësimi i projekt-propozimit për secilin aplikues bëhet edhe sipas tabelës numër 2.6 për dokumentacionin që çdo aplikues ofron.

¹ Për aplikacionet fituese, pas nënshkrimit të kontratës, oferta/profatura nuk mund të ndërrohet.

1.7. • LOT 2- Fondi I veçant për gratë në biznes,

Ky fond ka për synim fuqizimin ekonomik të gruas përkatësisht promovimi-min e ndërmarrësisë së grave. Ky fond do të nxisë dhe mbështesë hapjen/zgjerimin e biznesit dhe nxitjen e bizneseve për punësim të grave, **vlera maksimale e financimit nga ana e Komunes se Ferizajt për një përfitues për këtë Loto apo Fond është 2,000.00 € (dymijëeuro).**

1.8. Kriteret e nevojshme për aplikim per LOT 2 -bizneset e grave

1. Të jetë ndërmarrje në pronësi të grave dhe 100% private (sipas definicionit të Kosovës) regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës.
2. **Veprimtaria e biznesit duhet të jetë prodhuese dhe përpunuese.**
3. Të jetë biznes që operon në Komunën e Ferizajt ku edhe do të bëhet investimi;
4. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës përpos pronarit me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
5. Pronarja e biznesit duhet të jete banore e Komunes se Ferizajt(të dëshmohet me Çertifikat të Vendbanimit)
6. **Te drejte aplikimi ne këtë loto kanë vetëm bizneset të cilat blejnë makineri për prodhim dhe përpunim.**

Vërejtje: nuk subvencionohen veglat e punës,subvencionohen vetëm makineritë për prodhim dhe përpunim

1.9. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim LOT 2-Bizneset e grave përfshijnë:

1. Formulari i Aplikacionit për bizneset ekzistuese të grave;
2. Kopja e dokumenti identifikues personal valid i lëshuar nga Republika e Kosovës;
3. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, çertifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues; (e aplikueshme për bizneset ekzistuese)
4. Oferta(Profatura) për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt *(oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit në ofertë dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës, gjithashtu oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje për mbështetje)*. ¹ **Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO**
5. Fotografite të paisjeve (fotografite duhet të jenë të dukshme dhe të qarta).
6. Çertifikata e Vendbanimit (e lëshuar pas datës së thirrjes publike)

2.0. **Vërejtje :Vlerësimi i projekt-propozimit për secilin aplikues bëhet edhe sipas tabelës numër 2.6 për dokumentacionin që çdo aplikues ofron.**

¹ Për aplikacionet fituese, pas nënshkrimit të kontratës, oferta/profatura nuk mund të ndërrohet.

3.0. • LOT 3- Mikrondërmarrjet ;

Mikrondërmarrjet prodhuese dhe përpunuese me të punësuar 1-9 persona do të mbështeten me qëllim të blerjes së makinerive same cilësore, **vlera maksimale e subvencionimit nga ana e Komunës së Ferizajt për një përfitues për këtë Loto është 2,000.00 € (dymijëeuro).**

2.1.Kriteret e nevojshme për aplikim per LOT 3 –Mbështetje të Mikrondërmarrjeve

- 1.Të jetë ndërmarrje e regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës.
2. Veprimtaria e biznesit duhet te jete prodhuese dhe perpunuese.
- 3.Të jetë biznes që operon në Komunën e Ferizajt ku edhe do të bëhet investimi;
- 4.Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjësi përveç pronarit me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
- 5.Pronari/ja biznesit duhet te jete banorë i/e Komunes se Ferizajt (të dëshmohet me Çertifikat të Vendbanimit)
- 6.Bizneset mikrondërmarrje konsiderohen biznese 1-9 puntorë.
- 7.Te drejte aplikimi ne kete lloto kane vetem bizneset te cilat blejne makineri per prodhim dhe perpunim.
- 8.Raporti i ATK-se i prezentuar nga biznesi lidhur me numrin e te punesuarve.

Vërejtje: nuk subvencionohen veglat e punës,subvencionohen vetëm makineritë për prodhim dhe përpunim

2.2. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim LOT 3 - Mbështetje të Mikrondërmarrjeve përfshijnë:

1. Formulari i Aplikacionit për Mikrondërmarrjet
2. Kopja e dokumenti identifikues personal valid i lëshuar nga Republika e Kosovës;
3. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues; (e aplikueshme për bizneset ekzistuese)
- 4.Oferta(Profatura) për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt *(oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit në ofertë dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës, gjithashtu oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje për mbështetje).* ¹ **Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO**
- 5.Fotografit e paisjeve (fotografitë duhet të jenë të dukshme dhe te qartë).
- 6.Raporti I ATK-së lidhur me nmrine te punesuarve.
7. Çertifikata e Vendbanimit e lëshuar pas dates së thirrjes publike.

Vërejtje :Vleresimi i projekt-propozimit për secilin aplikues bëhet edhe sipas tabelës numër 2.6 për dokumentacionin që çdo aplikues ofron.

¹ Për aplikacionet fituese, pas nënshkrimit të kontratës, oferta/profatura nuk mund të ndërrohet.

Vërejtje: Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë. Dokumentet për aplikim, mund të shkarkohen nga web faja zyrtare e Komunës së Ferizajt

2.3. Kostot e pa kualifikueshme

Kostot vijuese nuk kualifikohen:

- Interesat e borxhit;
- Tatimet në të hyra;
- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim apo program tjetër pune;
- Humbjet në këmbim të valutës;
- Kostot e artikujve apo pajisjeve të përdorura;
- Pagat dhe medijt;
- Shpenzimet e lëndës së parë;
- Shpenzimet tjera operationale (qiraja, rryma, uji etj.)
- Automjetet e transportit;
- Shpenzimet e transportit;
- Inventari (Tavolinat, karriget dhe dollapet, në përjashtim ato që ndërlidhen në mënyrë specifike me veprimtarinë)

Çdo tentim për mashtrim (p.sh. blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me mos-pagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës.

Subvencionohet vetëm blerja e pajisjeve të reja.

Është në interesin e aplikantit të paraqes **buxhet realist dhe efektiv për kostot.**

2.4. Veprimtaritë që nuk kualifikohen

Tregtia (me pakicë e shumicë në kuptimin e shiteblerjes), ndërtimtaria, bujqësia, arsimi, shëndetësia, sallonet e ondulimi janë sektorë që NUK KUALIFIKOHEN

2.5. Kontrolli Administrativ

Në fazën e kontrollit administrativ të aplikacioneve për grante, Komuna e Ferizajt do të shqyrtojë dhe verifikojë aplikacionet e pranuar. Në këtë fazë verifikohet se a janë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme të kërkuara në udhëzues.

Në përgjithësi, faza e kontrollit administrativ të programit të grantit është një hap i rëndësishëm për të siguruar që fondet e grantit të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe efektive, dhe që projektet e zgjedhura janë në përputhje me udhëzimet në këtë dokument. **Aplikimet që nuk kalojnë kontrollin administrativ, nuk kalojnë në fazën e dytë të vlerësimit.**

Vlerësimi i Aplikacioneve do të përfshijë një kontroll administrativ për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit (p.sh. aplikantët janë shtetas të Kosovës, si dhe biznesi është regjistruar në Kosovë dhe vepron në territorin e Komunës së Ferizajt).

2.6.Vlerësimi i projekt-propozimit – kriteret

Projektet që kalojnë fazën e kontrollit administrativ, **kalojnë në fazën e vlerësimit të projektit.**

Vlerësimi bëhet duke u bazuar në tabelën e më poshtme, e cila rrjedh nga qëllimet e kësaj thirrjeje.

	Pikët
1.Ideja e biznesit dhe inovacioni	Totali(25 pikë)
Idetë për zhvillimin e kapaciteve biznesore e cila parqitet përmes përshkrimit në formë projekti	1-25 pikë
2.Potenciali i tregut dhe përvoja e aplikuesit	Totali(35 pikë)
Madhësia e tregut dhe potenciali i rritjes	1-15 pikë
Avantazhi konkurrues dhe diferencimi	1-15 pikë
Përvoja dhe aftësitë përkatëse të aplikuesit	1-10 pikë
3.Qëndrueshmëria financiare	Totali(10 pikë)
Parashikime financiare realiste	1-10 pikë
4.Ndikimi social dhe mjedisor	Totali(30 pikë)
Projekti ka ndikim pozitiv në ambient	1- 10 pikë
Aplikuesi është grua	5 pikë
Aplikuesi është pjesëtar i komunitetit pakicë	5 pikë
Aplikuesi është me aftësi të kufizuara	5 pikë
	TOTALI : 100 Pikë

Vërejtje: Në rast se një aplikues paraqesin përshkime të njëjta me një aplikues tjetër (i cili ka aplikuar i pari) sipas tabelës së lartecur konkretisht sipas pikës 1,2,3, dhe 4 , diskualifikohen nga gara automatikisht.

PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR PËR APLIKIM

Periodha e aplikimit do të jetë e hapur nga **16.05.2025-26.05.2025**

Aplikacionet duhet të plotësohen në formë kompjuterike duke mos ndryshuar formatin e aplikacioneve të dizajnuara nga Komuna e Ferizajt për këtë thirrje. Aplikacionet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Vetëm formularët e plotësuar me të gjitha informatat relevante në lidhje me veprimtarinë, do të kalojnë për vlerësim.

Në rastet kur ka mos përputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzitet në përshkrim të projektit dhe gabim në përdorimin e formateve të përcaktuara në thirrjen për propozime, projekti do të diskualifikohet.

Komuna e Ferizajt nuk është përgjegjëse për koston që ndërlidhet me përgatitjen e aplikacionit dhe se këto shpenzime nuk janë të pranueshme nëse përfshihen në projekt.

Aplikacionet duhet të plotësohen në gjuhën shqipe.

2.7.Afati i fundit për aplikim 26.05.2025

Afati i fundit për aplikim është **26.05.2025 në ora 16:00**. Aplikacionet e kompletuara në një kopje fizike duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në Qendrën për Shërbime me Qytetarë (QSHQ), Komuna e Ferizajt me shenimin **“FONDI PËR SUBVENCIONIMIN E START-UP ,MIKRONDËRMARRJEVE, DHE BIZNESET E GRAVE**

emri i plotë i aplikuesit si dhe LOT-in për të cilin aplikohet.

Aplikanti/ja nuk mund të përzgjedhet përfitues më shumë se një Loto.

Aplikacionet e pranuar pas përfundimit të këtij afati nuk do të merren parasysh në çfarëdo rrethane.

Përfituesit (pronarët e bizneseve) që kanë përfituar grante nga Komuna e Ferizajt, gjatë vitit 2023 dhe 2024 nuk kanë të drejtë aplikimi për këtë thirrje, në rast se përfituesi/ja e një biznesi e cila është subvencionuar gjatë vitit 2023,2024 aplikohen diskualifikohet nga gara.

Kohëzgjatja e planifikuar për blerjen e paisjeve nuk mund të tejkalojë tre (6) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës në të kundërtën komuna e Ferizajt nuk e kryen pagesën e subvencionimit.

Grantet jepen në formën e parave të gatshme, pasi që biznesi sjell dëshminë respektivisht faturën e rregullt për blerjet (investimet) që i ka bërë, e të cilat duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesën për investim që e ka dëshmuar me profaturë/ofertë.

Profaktura që biznesi e paraqet gjatë aplikimit dhe Faktura e rregullt që biznesi e merr pasi ta blenë paisjen duhet të ketë përputhshmëri të plotë njëra me tjetrën, në asnjë formë nuk lejohet ndryshimi i specifikave të paisjes.

Procedura e Pagesës për Përfituesit e Grantit

Për të lehtësuar dhe përshpejtuar procesin e aplikimit dhe pagesës dhe të thjeshtesohen procedurat e nevojshme për pagesat e granti, kjo do të realizohet në mënyrë që të eliminojmë nevojën për të realizuar transaksione bankare paraprake nga bizneset për blerjen e pajisjeve.

Përditësimi i kërkesës për fatura dhe verifikim:

1. **Nënshkrimi i kontratës:** Pas nënshkrimit të kontratës me Komunën e Ferizajt, biznesi përfitues është i obliguar të dorëzojë faturen e rregullt që është e nënshkruar dhe e vulosur nga të dy palët (shitësi dhe blerësi) dhe është e shënuar nga ana e shitësit që fatura është paguar (E PAGUAR)
2. **Verifikimi i pajisjeve:** Komisioni i Komunës do të dalë në terren për të verifikuar nëse pajisjet janë të njëjta si ato që janë specifikuar dhe nëse janë të reja (duke bere edhe rexhistrimin e tyre ne procesverbal ne baze te numrit serik) ky verifikim do të kryhet për të siguruar që pajisjet janë të konformuara me kërkesat dhe specifikimet e kontratës.
3. **Përgjegjësia:** Pas dorëzimit të faturës dhe verifikimit të pajisjeve, Komuna do të pranojë dhe procesojë përfitimin e grantit. Kjo procedurë është nën përgjegjësinë e shitesit dhe blerësit për lëshimin e fatures.

Lëshimi i fatures, që argumenton blerjen e pajisjeve, është nën përgjegjësinë e plotë të shitesit dhe blerësit, të cilët duhet të sigurojnë që fatura të jetë e rregullt dhe ti kete plotësuar kushtet në momentin e lëshimit të fatures.

Vërejtje:

Nga momenti i nënshkrimit të kontratës me secilin përfitues, përfituesi është i obliguar që ti përmbahet kushteve të kontratës, vlen të ceket që përfituesi nuk ka të drejtë që paisjen ta ndërroj, shesë apo të huazoj tek pala tjetër në afate kohor prej 3 vite duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës

Pas nënshkrimit të kontratës për secilin përfitues, formohet komisioni nga ana e Komunës së Ferizajt, Komisioni i cili monitoron gjendjen faktike në teren dhe në rast të keqpërdorimit eventual do të ndjekin rrugët ligjore.

Komuna e Ferizajt do të themelojë komision për vlerësimin e aplikacioneve.

Pas publikimit të rezultateve aplikantët e pakenaqr mund të adresojnë ankesa përmes Qendres per Sherbim me Qytetare ne Komunen e Ferizajt tek komisioni per shqyrtimin e ankesave brenda 5 ditëve kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

komision për shqyrtimin të ankesave vlerson pretendimin ankimor të paraqit nga ankuesi dhe brenda 5 dite pune komisioni u kthen pergjigje.

Pas përzgjedhjes dhe para nënshkrimit të kontratës, janë të nevojshme këto dokumente:

- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare,xhirollogaria bankare duhet te jete ne emër të biznesit perfitues.
- Çertifikata e regjistrimit me informatat përcjellëse (për LOT 1-bizneset start up).